

Shtojca 2 :

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

Nr. _____ prot.

Komisioni i Përherëshëm "I Zhvillimit Ekonomik , Financës dhe Tatim Taksave"

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.01 datë 25.05.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Shpërndarjen e të ardhurave të trashëguara nga viti 2025, në buxhetin e vitit 2026".

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore) Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me VKM rr.664, datë 24.10.2024, për propozimin e projektligjit, "Për buxhetin e vitit 2025", të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", shkresën nr. 18263, datë 29.12.2025 „Për buxhetin e vitit 2026“, si dhe të vendimit nr. 70, datë 24.12.2025 të Këshillit Bashkiak Libohovë „Për miratimin e buxhetit të vitit 2026“

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit) Të ardhura të trashëguara nga viti 2025 nga transfertat e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar sektoriale është 46,527,392.05, të ardhura të trashëguara për t'u shpërndarë 46,527,392.05, të ardhura të trashëguara nga të ardhurat e veta 26,468,331.51, të ardhura të trashëguara për t'u shpërndarë 26,468,331.51

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet) Rritje e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve, pjesë e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2026"

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit për "Shpërndarjen e të ardhurave të trashëguara nga viti 2025, në buxhetin e vitit 2026".

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Zhvillimit Ekonomik, Financave dhe Tatim Taksave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Sektorin e Zhvillimit e Menaxhimit Financiar ose Sektorët përgjegjës për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt akt impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të Bashkisë Libohovë

A është objekt i konsultimit publik: JO

Komisioni i Përhershëm për “Ekonomi Financë dhe Zhvillim Ekonomik”, i mbledhur me datën 08/06/2026, shqyrtoi projekt vendimit nr.01 datë 25.05.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Shpërndarja e të ardhurave të trashëguara nga viti 2025, për buxhetin e vitit 2026” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni e me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----”

✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----”

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----”

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “-----”

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Krenar Kulla Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Elisabeta Kokoshi Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë, 08.06./2026